



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.976/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit M&V Group Company shpk, me numër unik identifikues 811386045, me seli ne Kaçanik rr.” Komandant Bardhi” pn, Kaçanik Vjetër, ndaj debitorit Lunari Company shpk, me numër unik identifikues 810156157 me seli ne fshatin Komogllavë Komuna Ferizaj, te cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat J.B., me seli te zyrës ne Ferizaj, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkallës se Parë, KPPP.nr.1353/22 datës 15.05.2023, me datën 06.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e debitorit Lunari Company shpk, me numër unik identifikues 810156157 me seli ne fshatin Komogllavë Komuna Ferizaj, ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkallës se Parë, KPPP.nr.1353/22 i datës 15.05.2023 dhe Lënda i kthehet Gjykatës Komerciale –Dhomës së Shkalles se Parë, në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës se Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1353/22 dt.15.05.2023, e ka Refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “Lunari Company” shpk, me numër unik identifikues 810156157 me seli ne fshatin Komogllavë Komuna Ferizaj, i paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.420/2021 dt.12.07.2021 te përmbaruesit Privat Sheremet Livoreka, për territorin e Gjykatës Themelore ne Ferizaj, ndërsa urdhrin përmbarimor i Përmbaruesit Privat P.nr.420/21 dt.12.07.2021 e ka lënë ne fuqi.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, përmes përfaqësuesit te autorizuar, për shkak te shkeljes se dispozitave te procedurës kontestimore dhe konstatimit te gabuar te gjendjes faktike, me propozim qe Gjykata e shkallës se dytë aprovoj këtë ankesë si te bazuar dhe aktvendimin e gjykatës e shkallës së parë ta prish ashtu qe çështja te kthehet ne rishqyrtim ne shkallë të parë.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të

Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “M&V Group Company” shpk, me numër unik identifikues 811386045, me seli ne Kaçanik rr.” Komandant Bardhi” pn, Kaçanik Vjetër, me datën 12.07.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit “Lunari Kompany” shpk, me numër unik identifikues 810156157 me seli ne fshatin Komogllavë Komuna Ferizaj, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës me nr.17/2021 dt.16.04.2021. Përmbartuesi Privat Sheremet Livoreka nga Ferizaj, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.420/2021 dt.12.07.2021, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit nga fatura t’i paguaj shumën prej 8,610.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% ne vit.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 21.07.2021 duke deklaruar se dokumenti ne baze te cilit është iniciuar propozimi për përmbartim nuk e ka kohen e përmbushjes çka do te thotë se nuk mund te ekzekutohet kërkesa për pagesë ne mënyrë te dhunshme derisa nuk ka kaluar afati vullnetar i pagesës që në rastin konkret akoma nuk dihet. Debitori një pjesë dërmuese te obligimeve nga fatura e ka përmbushur me zhavorr për te cilat kreditori nuk ka paguar por jemi zbatuar me zall, këtu debitori i referohet fletëdërgesave si ne prapësim me çka konsideron se tashmë faturat janë përmbushur nga ana e debitorit, andaj propozon qe gjykata ta miratoj prapësimin e debitorit, urdhri përmbartimor te anulohet dhe propozimi për përmbartim te refuzohet ndërsa të obligohet kreditori qe ti paguaj shpenzimet e përpilimit te prapësimin.

Kreditore me datën 03.08.2021 ka ushtruar përgjigje ne prapësimin e debitorit, me pretendimin që urdhri përmbartimor është i bazuar ne faturën nr.17/2021 dt.16.04.2021, dhe se debitori nuk ka ofruar asnjë fakt ose transfer bankar sepse kredia nuk është përmbushur, pastaj debitori nuk ofron asnjë dëshmi apo marrëveshje ne mes palëve për tu zbatuar borxhi, provat që i ka bashkangjitur debitori nuk janë dëshmi e barazimit dhe as zbatimit te palëve sepse këto fletë dërgesa nuk kane të bëjnë fare me këtë procedurë përmbartimore, andaj propozon qe gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit, ta vërtetoj urdhrin përmbartimor dhe ta obligoj debitorin qe ti paguaj shpenzimet për përpilimin e kësaj përgjigje ne prapësim .

Gjykata Komerciale -Dhoma e shkallës së Parë, pas shqyrtimit te prapësimin dhe përgjigjes në prapësim ka gjetur se pretendimet e debitorit janë të pabazuara dhe paargumentuara dhe jo siç parasheh neni 69 i LPP. Dokumenti ne baze te cilit është iniciuar procedura përmbartimore plotëson kushtet ligjore nga neni 29 par.3 i LPP si dhe neni 38 par.1 i LPP, i njëjti është pranuar ne mënyre te rregullt nga debitori dhe është vulosur nga i njëjti. Gjykata ka trajtuar edhe pretendimin e debitorit sa i përket maturimi të kredisë së kërkuar me propozim për përmbartim por se e njëjta vlerësoi se meqë nuk ka pasur afat te përmbushjes vullnetare te detyrimit gjykata konsideron se meqë kemi te bëjmë me pranim te rregullt te faturës afati i përmbushjes së detyrimit ka qenë ne

ditën e faturimit apo ne mënyrën e njëhershme pas pranimit. Debitori ka pasur ne dispozicion edhe kohen në mes te datës se nxjerrjes se faturës 16.04.2021 e deri ne datën e pranimit te urdhrin përmbarimor për përmbushje vullnetare apo edhe afatin 7 ditor pas pranimit te urdhrin përmbarimor për përmbushje te detyrimit. Gjykata sa i përket pretendimit te debitorit përkitazi raportit kompensues me material ndaj kreditorit konsideron se nuk është objekt i shqyrtimit te kësaj procedure, andaj edhe ka vendosuri si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

Gjykata Komerciale -Dhomat e shkallës se Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë ne shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe me shkelje të nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3 dhe par.3 të LPP-së.

Në këtë kontekst, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka analizuar saktë shkresat e lëndës si dhe nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike përkitazi çështjes se fatura në bazë të cilës është lejuar përmbarimi, a i plotëson kushtet ligjore për tu konsideruar si dokument i besueshëm dhe se e njëjta a përmban te gjitha elementet qe kërkohen me dispozitat ligjore nga neni 29 te LPP. Nga shkresat e lëndës shihet qartë se fatura nr.17/2021 dt.16.04.2021 në bazë të cilës është lejuar përmbarimi nuk përmban elementet qe kërkohen me nenin 29 par.3 te LPP i cili thotë se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar, e që në rastin konkret fatura nuk posedon afatin kohor te përmbushjes së detyrimit nga debitori. Nuk qëndron arsyetimi i gjykatës së shkalles se parë se meqë kemi te bëjmë me pranim te rregullt te faturës afati i përmbushjes se detyrimit ka qenë ne datën e faturimit apo ne mënyrë te njëhershme pas pranimit, e kjo sepse as ne propozimin për përmbarim si edhe as ne urdhrin përmbarimor nuk i është dhënë afat partitiv debitorit për përmbushje dhe se askund ne shkresa te lëndës nuk rezulton se kreditori ka vepruar sipas nenit 30 te LPP-së, ne mënyrë qe kredinë e tij ta bëjë te kërkueshme ndërsa me dispozitat ligjore është përcaktuar saktë çështja e përmbajtjes e një dokumenti te besueshëm e përfshirë këtu saktësisht kohen e përmbushjes së detyrimit monetar.*

Andaj me qëllim te analizimit dhe verifikimit te faturës mbi bazën e se cilës është lejuar përmbarimi, kërkueshmërisë se kredisë nga kreditori si dhe shqyrtimit te pretendimit te debitorit se një pjesë te detyrimeve e ka përmbushur duke ofruar si provë disa fletëdërgesa te cilat gjendjen ne lëndë rezulton se aktvendimi i ankimuar duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në procedim të serishëm në gjykatën e shkallës së parë, ndërsa gjykata e shkalles e parë me qëllim te konstatimit te saktë te gjendjes se fakteve mund eventualisht te veproji konform nenit 73 par.1 te LPP për caktimin e seancës dëgjimore.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh te gjeturat e gjykatës se shkalles se dytë, të vlerëson në mënyrë të drejtë dokumentin e besueshëm, nëse fatura sipas dispozitave të LPP-së, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm, te analizoj dispozitën e nenit 30 te LPP konform veprimeve te kreditorit, eventualisht te caktoj seancë dëgjimore në kuptim të

dispozitave të lartcekur ku do të ftohen palët ndërgjyqëse, me qëllim të deklarimit rreth pretendimeve të tyre, ashtu që të konstatohet saktë gjendja faktike, e më pastaj varësisht nga të gjeturat dhe në vlerësim edhe të nenit 71 të LPP, edhe të vendos konform dispozitave ligjore duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II nr.976/23, me datë 06.03.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha